# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-444290**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Abdixhiku pas tërheqjes së Sejdiut: Tregoi dinjitet, sa shumë kemi nevojë për njerëz të mirë |
| ADRESA | `https://piranjat.al/bota/pas-protestave-masive-ne-serbi-vucic-njofton-do-te-jap-doreheqjen-me-27-sht-i104113` |
| BURIMI | piranjat.al |
| GJENDJA | edited |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 19:05:56 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 14 shtator 2026, 19:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `7df6725e38e1c9d141c1bcef66a323a101b3288f34b84fd0bf3d8234def81f73` |
| TEKSTI | `180c73c83c63e26e40de64f5f37aa247ca42e7a32a70c94d47a1260eceddd4d4` |
| PAMJA | `c2bb81daa34c4b1873a7abd270fcd209c6e29044a0bb305eecb15fa0d5da9ee8` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `645f6d7f45f75d76e0c297dc84aa5854586c9855b305ed045d8e055fa3510c43` |
| E MËPARSHMJA | `39c951b27f438d4d3c1bff0f8f41c8767b12e727ea63402f3a745552a8aae0ed` |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/645f6d7f45f75d76e0c297dc84aa5854586c9855b305ed045d8e055fa3510c43`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

KOSOVA

# Abdixhiku pas tërheqjes së Sejdiut: Tregoi dinjitet, sa shumë kemi nevojë për njerëz të mirë

Piranjat Përditësimi i fundit 14 Shtator 2026, 21:00



Lumir Abdixhiku (Facebook)

Kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Lumir Abdixhiku, ka reaguar pas tërheqjes së Bekim Sejdiut nga kandidatura për president të Kosovës, duke thënë se ai tregoi dinjitet përballë, siç e quajti, "histerisë politike".

Abdixhiku ka deklaruar se tërheqja e Sejdiut dëshmon, sipas tij, se ai do të ishte zgjedhja e duhur për president.

"Bekim Sejdiu tregoi dinjitet. Tërheqja e tij, përballë histerisë politike, dëshmon pikërisht pse një njeri me karakterin e tillë, do të ishte zgjedhja e duhur për President", ka shkruar Abdixhiku.

Kreu i LDK-së ka shprehur keqardhje që Kosova aktualisht nuk ka president dhe se, sipas tij, në vend të një zgjidhjeje politike, vendi po përballet me kaos, bllokadë dhe mundësinë e zgjedhjeve të reja.

"Keqardhje që sot nuk kemi President. Që në vend të një zgjidhjeje kemi kaosin politik, bllokadën si mjet dhe zgjedhjet e reja, edhe një herë, si qëllim", ka deklaruar ai.

Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për president: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare

Abdixhiku ka kritikuar edhe sulmet ndaj Sejdiut gjatë procesit të kandidimit, duke thënë se ato kishin për qëllim dëmtimin e figurës së tij.

"Keqardhje edhe për Bekimin, që padrejtësisht u bë shënjestër e sulmeve të paprecedenta për mbytjen e karakterit të tij. Përbaltja e tij kishte të bënte më së paku me të", ka shkruar ai.

Sipas Abdixhikut, në politikën kosovare urrejtja dhe inati personal janë bërë më të forta se përgjegjësia ndaj vendit.

"Sa shumë kemi nevojë për njerëz të mirë në këtë vend. Sa lehtë i hedhim poshtë", ka thënë ai.

Abdixhiku e ka cilësuar situatën aktuale si "PISA politike të Kosovës", duke akuzuar klasën politike për bllokim dhe dështim për të gjetur zgjidhje institucionale.

"Kjo është PISA politike e Kosovës. Me rëndësi të rrënojmë çdo përpjekje normale sot! Bllokohemi, ngecim, urrejmë, mbysim karaktere dhe përfundojmë sërish në zgjedhje. Edhe pas tyre, në të tjerat", ka shkruar ai.

Në fund, Abdixhiku e ka falënderuar Sejdiun për gatishmërinë dhe qëndrimin e tij gjatë procesit. "Të faleminderit Bekim për gatishmërinë dhe dinjitetin e treguar në vazhdimësi. Në kohë të politikës së sotme, këto virtyte janë vlerë", ka shkruar Abdixhiku.

## Artikuj te sugjeruar

KOSOVA 14 Shtator20:46

**"Sa shumë drama politike"/ Bekim Sejdiu flet pas tërheqjes së kandidaturës për President: Po venitet shpresa e qytetarëve**

Emri që u propozua para disa javësh si kandidat konsensual për president, ka vendosur të heq dorë. Bekim Sejdiu ka njoftuar se ka vendo...

KOSOVA 14 Shtator19:45

**16 shtatori në Kosovë/ Ambasada amerikane paralajmëron protesta, udhëzim për punonjësit dhe shtetasit amerikan**

Ambasada amerikane në Kosovë ka paralajmëruar ditën e mërkurë më 16 shtator protesta të mëdha q priten të zhvi...

KOSOVA 14 Shtator19:11

**Bekim Sejdiu tërhiqet nga kandidatura për President të Kosovës**

Bekim Sejdiu ka njoftuar se është tërhequr nga kandidatura për president të Republikës së Kosovës, duke thënë ...

KOSOVA 14 Shtator18:08

**Verdikti për ish-krerët e UÇK-së, Kosova në gatishmëri! Policia paralajmëron kufizime të përkohshme në qarkullim më 16 shtator**

Policia e Kosovës ka shtuar masat e sigurisë në prag të 16 shtatorit, ditë kur pritet të shpallet në Hagë aktgjykimi p&e...

KOSOVA 14 Shtator17:28

**Avokatja e Thaçit: Kundërshtojmë të gjitha transkriptet, fajësia nuk mund të mbështetet në to**

Avokatja Sophie Menegon, e cila përfaqëson Hashim Thaçin në çështjen për administrimin e drejtësisë në Gjy...

KOSOVA 14 Shtator17:03

**Vendimi për ish-krerët e UÇK, Rutte: KFOR-i është aty, pavarësisht se ç'mund të ndodhë këtë javë në Kosovë**

Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Mark Rutte, tha se përkushtimi i Aleancës për ruajtjen e paqes dhe sigurisë në Kosovë...

KOSOVA 14 Shtator12:43

**"E pafalshme"/ Albin Kurti: Të zgjidhim sa më shpejt çështjen e presidentit, zgjedhjet e reja do ishin katastrofë**

Kryeministri i Kosovës Albin Kurti u ka bërë thirrje deputetëve dhe drejtuesve politikë që të përmbyllin procesin p&eu...

KOSOVA 14 Shtator11:23

**Gjyqi ndaj ish-krerëve të UÇK-së në Hagë/ Ambasada amerikane në Prishtinë paralajmëron protesta të mëdha në 16 shtator**

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës në Prishtinë ka paralajmëruar qytetarët për protesta të mëdha q...

KOSOVA 14 Shtator08:32

**Akuza e Hagës për pengim të drejtësisë/ Prokuroria kërkon 6 vite burg për Hashim Thaçin, sot mbahen deklaratat përfundimtare**

Procesi gjyqësor në Dhomat e Specializuara të Hagës ndaj ish-presidentit të Kosovës, Hashim Thaçi, si dhe ndaj Bashkim Sm...

KOSOVA 13 Shtator23:39

**LVV dhe LDK me një emër për presidentin, deputeti Kraki: Bashkë i kemi numrat! Ju bëj thirrje…**

Deputetit i Lëvizjes Vetëvendosje, Nezir Kraki i ftuar këtë të dielë në emisionin "Review" me Greta Topjana n&eum...

## ME TE VIZITUARAT

AKTUALITET 13 Shtator

**Të shtëna me armë pranë një lokali në Greqi, dy...**

Shqiptari Alket Rizai, ish-bashkëpunëtor i të shumëkërkuarit grek Vasilis Paleokostas dhe i njohur për arratisjen dy herë m...

POLITIKE 14 Shtator

**FOTO- 'Mos u kthe më në Shqipëri'/ Edi Rama sul...**

Edi Rama ka sulmuar me thonj dhe ka kërcënuar një emigrant shqiptar në Napoli duke iu drejtuar me fjalët: Të zhduk. Gazetari &C...

AKTUALITET 13 Shtator

**E rëndë në Patos, një person gjendet i pa jetë ...**

Një ngjarje e rëndë ka ndodhur pak më parë në Patos.Një person është gjetur i pa jetë në oborrin e bane...

INVESTIGIME 31 Maj14:01

**Gratteri për Piranjat: Kam 38 vite që më duan të vdekur ndaj nuk dal kurrë në publik**

Për më shumë se tre dekada, jeta e kryeprokurorit italian të antimafias, Nicola Gratteri, ka qenë nën hijen e kërcënimev...

### video



### Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV





**Çdo të premte | ? 20:45 | ???? Syri TV**




**Si u tentua të shantazhohej me 100 mijë euro shefi i kabinetit të Përparim Ramës përmes mediave**





**PIRANJAT SHOW - SEZONI 9 EPISODI 16**



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.